



Kosova (s)KA

korrupsion të profilit të lartë



Autorët: Betim Musliu dhe Yll Zekaj

Redaktorët: Ehat Miftaraj dhe Hyrije Mehmeti

Asnjë pjesë e këtij materiali nuk mund të printohet, kopjohet, shumëfishohet në çdo formë elektronike ose të shtypur, ose në çdo formë të shumëfishimit tjetër pa pajtimin e Institutit të Kosovës për Drejtësi.

Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi ekskluzive e Institutit të Kosovës për Drejtësi - IKD dhe ajo nuk pasqyron pikëpamjet e Byrosë së Narkotikëve Ndërkombëtar dhe Çështjeve të Zbatimit të Ligjit (INL) - Departamenti i Shtetit Amerikan dhe NED-it.

RRETH IKD

IKD, Instituti i Kosovës për Drejtësi, është organizatë jo-qeveritare dhe jo-fitimprurëse e politikave publike, fabrikë e mendimeve e specializuar në sektorin e drejtësisë.

IKD

Rr. Rrustem Statovci

Prishtinë

E-mail: info@kli-ks.org

Ueb: www.kli-ks.org

Përkrahur nga:



**National Endowment
for Democracy**

Supporting freedom around the world

Dhjetor 2019

Prishtinë, Republika e Kosovës

Përmbajtja

I.	Përmbledhje ekzekutive	5
II.	Trajtimi i rasteve të korrupsionit nga sistemi prokurorial.....	6
a)	Hetimet në rastet e korrupsionit nga sistemi prokurorial	6
b)	Hetimet preliminare të korrupsionit nga sistemi prokurorial	8
c)	Ngritja e aktakuzave për korrupsion dhe profili i të akuzuarve	8
III.	Performanca e Prokurorisë Speciale në luftimin e korrupsionit	10
IV.	Politika e dënimeve për rastet e korrupsionit sipas Mekanizmit Përcjellës - KGJK.....	14
V.	Monitorimi i rasteve të korrupsionit nga IKD.....	16
a)	Analizë e veçantë e rasteve të korrupsionit të profilit të lartë.....	16
b)	Politika e dënimeve në rastet e korrupsionit	17
VI.	Trajtimi i rasteve të korrupsionit në Gjykatën e Apelit.....	18
VII.	Trajtimi i rasteve të korrupsionit nga Gjykata Supreme	24
VIII.	Konkluzionet.....	28
IX.	Rekomandimet	29

Shkurtesat

GjEDNj	Gjykata Evropiane për të Drejta të Njeriut
GjTh	Gjykata Themelore
IKD	Instituti i Kosovës për Drejtësi
KGJK	Këshilli Gjyqësor i Kosovës
KPK	Këshilli Prokurorial i Kosovës
KPPK	Kodi i Përkohshëm Penal i Kosovës
KPPRK	Kodi i Procedures Penale i Republikës së Kosovës
KPRK	Kodi Penal i Republikës së Kosovës
KRPRK	Kodi i Ri Penal i Republikës së Kosovës
LDP	Ligji për deklarimin e pasurisë
LGJ	Ligji për Gjykatat
LKGJ	Ligji për Këshillin Gjyqësor
LKP	Ligji për Këshillin Prokurorial
LPSH	Ligji për Prokurorin e Shtetit
PTH	Prokuroria Themelore

I. Përmbledhje ekzekutive

Asnjë aktgjykim i formës së prerë nuk është shqiptuar me burgim efektiv për vepra penale të korrupsionit ndaj profilit lartë. Zyrtarët e lartë publik vazhdojnë të amnistohen nga ndjekja penale e bazuar në hetim dhe ndjekje profesionale, dhe gjykime të drejta, paanshme dhe të pavarura që do të rezultonin me shqiptimin e dënimeve me burgim efektiv.

Prokuroritë dhe Gjykatat ende vazhdojnë luftën kundër korrupsionit kryesisht tek korrupsioni i nivelit të ultë, dhe niveli i mesëm dhe rrallë herë kundër nivelit të lartë. Prokuroritë në vitin 2019, kanë pasur në punë lëndë të korrupsionit ndaj 854 personave të akuzuar, ku prej tyre 443 persona i takojnë profilit të ulët, 357 persona profilit të mesëm dhe 54 persona i takojnë të profilit të lartë.

Sekuestrimi dhe konfiskimi i pasurisë së fituar në mënyrë të kundërligjshme përmes veprave penale të korrupsionit ende është një temë tabu dhe pa asnjë rezultat në sistemin prokurorial dhe gjyqësor. Prokurorët ende punën e tyre e bazojnë në logjikën e ngritjes së aktakuzave por jo edhe identifikimin e pasurisë së fituar në mënyrë të kundërligjshme, parashtrimin e kërkesave për sekuestrim dhe konfiskim të pasurisë.

Prokuroria Speciale njëjtë sikurse edhe në vitet e kaluara (2016, 2017, 2018) edhe në vitin 2019, ka vazhduar me trendin e ikjes në marrjen e përgjegjësive për trajtimin e rasteve të korrupsionit. Kjo Prokurori nga 1 janari 2019 e deri më 30 shtator 2019 nuk ka ngritur asnjë aktakuzë ndaj profilit të lartë për vepra penale korruptive. Prokurorët në këtë prokurori nuk janë të profilizuar dhe specializuar në fusha të veçanta. Prokurorët në PSRK vazhdojnë që në të njëjtën kohë të trajtojnë lëndë të fushave të ndryshme si lëndë të krimit të organizuar, korrupsionit, krimeve të luftës, pastrimit të parasë, vrasjeve, trafikimit, etj. Mungesa e profilizimit të prokurorëve, dhe shpërndarja e rasteve të korrupsionit dhe krimeve ekonomike të një numër i madh i prokurorëve në PSRK është edhe tendencë dhe politikë e kësaj prokurorie në shpërndarjen e përgjegjësive dhe llogaridhënies.

Politika ndëshkimore të rastet e korrupsionit ende mbetet sfidë për gjykatësit në të gjitha gjykatat e Kosovës. Sistemi gjyqësor ende nuk është në gjendje të zbatoj politikë ndëshkimore unike dhe në pajtim me frymën dhe qëllimin e vet Kodit Penal të Kosovës. Gjatë kësaj periudhe raportuese numri më i madh i dënimeve të shqiptuara nga gjykatat janë dënime me kusht dhe me gjobë, pasuar nga dënimet me burgim. Sidoqoftë, viti 2019, në krahasim me vitetet paraprake për herë të parë ka shënuar ngritje të numrit të dënimeve me burgim efektiv të shqiptuara nga gjykatat e Kosovës, por jo ndaj profilit të lartë të korrupsionit.

Mungesa e kontrollit gjyqësor në fazën e hetimeve preliminare vazhdon të përbën një prej formave më persekutuese të hetimit dhe ndjekjes së qytetarëve apo zyrtarëve që janë subjekt të kallëzimeve të ndryshme penale. IKD ka identifikuar këtë problem, ende të paadresuar, të zhvillimit të hetimeve nga policia dhe prokuroria, pa asnjë kontroll efektiv të gjyqësorit, përmes të cilit vazhdojnë të persekutohen palët e ndryshme, duke ua shkelur të drejtat dhe liritë themelore të njeriut.

II. Trajtimi i rasteve të korrupsionit nga sistemi prokurorial

PSh gjatë periudhës raportuese janar-shtator 2019, ka pasur në total në punë, 553 raste me 1289 persona të përfshirë lidhur me veprat penale të korrupsionit. Nga këto raste, PSh nga vitet paraprake kishte trashëguar 274 raste të korrupsionit me 725 persona të përfshirë, përderisa përgjatë periudhës raportuese kishte pranuar në punë 279 raste të reja të korrupsionit me 564 persona të përfshirë. (Shih tabelën)

a) Hetimet në rastet e korrupsionit nga sistemi prokurorial

Prokuroria	Raste të pazgjidhura në fillim	Personat rastet e të cilëve kanë ngelur të pazgjidhura në fillim	Rastet e pranuar-të reja (përfshirë edhe ndajen e procedurës)	Personat e dyshuar rastet e të cilëve janë pranuar në punë dhe persona të dyshuar me zgjerimin e hetimit	Gjithsej raste në punë	Gjithsej persona rastet e të cilëve janë në punë	Rastet e zgjidhura dhe të dërguara në kompetencë		Raste të pazgjidhura në fund	Personat rastet e të cilëve kanë ngelur të pazgjidhura në fund
							Rastet e zgjidhura	Personat për të cilët janë zgjidhur rastet		
PSRK	17	93	12	70	29	163	2	13	27	150
Prishtinë	110	355	99	177	209	532	106	195	103	337
Prizren	28	63	72	162	100	225	54	112	46	113
Pejë	6	15	12	12	18	27	12	19	7	8
Gjilan	8	19	29	42	37	61	29	47	8	14
Mitrovicë	68	102	24	42	92	144	21	39	71	105
Ferizaj	22	63	14	20	36	83	21	33	15	50
Gjakovë	15	15	17	39	32	54	18	25	14	29
Gjithsej	274	725	279	564	553	1289	263	483	291	806

Tabela 1 – Trajtimi i rasteve të korrupsionit në sistemin prokurorial për nëntëmuajorin 2019.

PSh gjatë kësaj periudhe raportuese ka zgjidhur 263 raste të korrupsionit ndaj 483 personave të përfshirë, respektivisht ky institucion ka arritur të zgjidh 16 raste më pak sesa që ka pranuar, përderisa ka zgjidhur raste të korrupsionit për 81 persona më pak sesa që ka pranuar gjatë të njëjtës periudhë kohore.

Në fund të kësaj periudhe raportuese, PSh-së i kanë mbetur në punë 291 raste me 806 persona të përfshirë në vepra të korrupsionit. Numri më i madh i rasteve të zgjidhura gjatë kësaj periudhe kohore i përket PTh në Prishtinë, me 106 raste dhe 195 persona, përderisa PSRK ka zgjidhur 2 raste me 13 persona, ndërsa ka në punë 27 raste me 150 persona.

Mënyra e zgjedhjes së rasteve të korrupsionit nga PSh

PSh gjatë kësaj periudhe raportuese ka zgjidhur raste të korrupsionit ndaj 483 personave, ku ndaj **216 personave është hudhur kallëzimi penal**, ndaj **116 personave është pushuar hetimi**, kurse ndaj **147 personave është ngritur aktakuzë**. Në bazë të përqindjes del se PSh ndaj 69% të personave kanë mbyllur rastet, kurse ndaj 31 % të personave kanë ngritur aktakuza. (Shih tabelën)

Personat rastet e të cilëve janë zgjidhur sipas mënyrës së zgjidhjes								
Prokuroria	Gjithsej persona	Është hudhur Kallëzimi penal /	Masat për trajtim Psikiatrik	Është Pushuar Hetimi	Aktakuzë për dhënien e urdhrat ndëshkimor	Është ngritur Aktakuzë e drejtpërdrejtë	Aktakuzë pas zhvillimit të hetimeve	Mënyrë tjetër (është bashkuar procedura,,)
PSRK	13			13				
Prishtinë	195	72	1	61	1	1	59	
Prizren	112	67		17			27	1
Pejë	19	5		3		1	10	
Gjilan	47	26		8		3	10	
Mitrovicë	39	20		1		1	15	2
Ferizaj	33	19		6		1	7	
Gjakovë	25	7		7			11	
Total	483	216	1	116	1	7	139	3

Tabela 3 – Mënyra e zgjidhjes së rasteve të korrupsionit në sistemin prokurorial.

PSRK gjatë kësaj periudhe kohore ka pushuar hetimet ndaj 13 personave, përderisa nuk ka hudhur asnjë kallëzim penal apo nuk ka ngritur asnjë aktakuzë.

b) Hetimet preliminare të korrupsionit nga sistemi prokurorial

PSh vitin 2019 e kishte filluar me 597 raste të korrupsionit me 1065 persona të përfshirë në procedurën parapenale. Përderisa gjatë periudhës raportuese PSh ka pranuar edhe 314 raste të reja me 601 persona të përfshirë, që në total i bie se Prokuroria gjatë këtij viti, e deri në fund të muajit shtator ka pasur në punë gjithsej 911 raste me 1666 persona të përfshirë.

Gjatë kësaj periudhe raportuese Prokuroria ka mbyllur 310 raste me 539 persona, përderisa në punë kanë mbetur të pazgjidhura edhe 601 raste me 1127 persona. (Shih tabelën)

Prokuroria	Informata të pambyllura-zgjidhura në fillim	Personat rastet e të cilëve kanë ngelur të pazgjidhura në fillim	Informata të pranuarra-të reja	Personat e dyshuar rastet e të cilëve janë pranuar në punë dhe persona të dyshuar me zgjerimin e hetimeve	Gjithsej raste-informata në punë	Gjithsej persona rastet e të cilëve janë në punë	Informata të përfunduara-mbyllura-zgjidhura	Personat për të cilët janë mbyllur informatat	Informatat e pambyllura-të pazgjidhura në fund	Personat rastet e të cilëve kanë ngelur të pa zgjidhura në fund
PSRK	31	96	32	75	63	171	18	50	45	121
Prishtinë	375	636	137	230	512	866	184	311	328	555
Prizren	21	35	42	82	63	117	31	56	32	61
Pejë	20	45	65	132	85	177	42	69	43	108
Gjilan			1	4	1	4			1	4
Mitrovicë	67	107	7	35	74	142	5	5	69	137
Ferizaj	53	100	12	13	65	113	20	34	45	79
Gjakovë	30	46	18	30	48	76	10	14	38	62
Gjithsej	597	1065	314	601	911	1666	310	539	601	1127

Tabela 4 – Inicimi i rasteve për hetime preliminare në sistemin prokurorial.

c) Ngritja e aktakuzave për korrupsion dhe profili i të akuzuarve

IKD ka vazhduar me monitorimin dhe analizimin e profilit të kryesve të veprave penale të korrupsionit në bazë të informatave të publikuara nga Prokurori i Shtetit (PSh) në faqen zyrtare, lidhur me aktakuzat kundër kryesve të veprave penale të korrupsionit gjatë periudhës 1 janar – 30 nëntor 2019.


Gjatë kësaj periudhe kohore, PSh ka publikuar njoftime të veçanta për ngritjen e 29 aktakuzave për vepra penale të korrupsionit, kundër 60 personave.

Profili i pozitave të personave ndaj të cilëve janë ngritur aktakuzat, përfshinë: prokuror, zyrtarë policor, zyrtarë komunal, nëpunës të Administratës në Qendrën e Regjistrimit të Automjeteve, biznesmenë dhe persona tjerë kryesisht të nivelit të ulët. Kurse, për 12 persona

nuk ka informata se cilit profil i takojnë. Megjithatë, vetëm një aktakuzë e ngritur gjatë kësaj periudhe raportuese përfshin një person të profilit të lartë dhe atë kryetarin e Komunës së Klinës, Zenun Elezaj.

Sipas aktakuzave të ngritura nga Prokuroritë, vetëm në disa prej tyre ka informacion sa i përket vlerës së dëmit të shkaktuar me veprat penale të korrupsionit, përdërisa në asnjërin njoftim nuk ka informacion nëse prokuroritë kanë paraqitur kërkesa për sekuestrim apo konfiskim të pasurisë së fituar me vepër penale.

Sipas të dhënave të publikuara, rezulton se prokuroria me efikase gjatë kësaj periudhe është PTh në Prizren me 18 aktakuza kundër 26 personave. Tutje, PSRK ka ngritur 3 aktakuza kundër 14 personave, PTh në Pejë ka ngritur 3 aktakuza kundër 7 personave, PTh në Ferizaj ka ngritur 2 aktakuza kundër 4 personave, PTh në Gjilan ka ngritur 1 aktakuzë kundër 6 personave, PTh në Gjakovë ka ngritur 1 aktakuzë kundër 2 personave dhe PTh në Mitrovicë ka ngritur 1 aktakuzë kundër 1 personi. *(Shih grafikën)*



Grafika 3 – Numri i aktakuzave të ngritura nga Prokuroritë dhe numri i të akuzuarve.

Nga monitorimi i njoftimeve nga PSh, rezulton se ky institucion nuk dërgon gjithnjë njoftime të veçanta për ngritjen e aktakuzave për raste të korrupsionit, por vetëm në disa raste caktuara, sikur ato të lartcekura.

Madje, ka raste kur PSh nuk njofton fare për ngritjen e një aktakuzë për korrupsion, si në rastin e ngritjes së aktakuzës nga PTh në Prishtinë, në prill të këtij viti, kundër zyrtarit policor Jeton Menxhiqi, për veprën penale “keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar”.

III. Performanca e Prokurorisë Speciale në luftimin e korrupsionit

Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës, e themeluar në vitin 2007 nga UNMIK-u si Zyrë e Prokurorit Special të Kosovës, në vitin 2008, me Ligjin për Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës është themeluar si një organ prokurorial i përhershëm dhe i specializuar që vepron në kuadër të Prokurorit të Shtetit. Kjo prokurori ka mandat dhe juridiksion në tërë territorin e Kosovës, në hetimin dhe ndjekjen e kryesve të veprave penale të përcaktuara me ligj, ku hyn kompetencat e veçanta (ekskluzive) dhe plotësuese.

PSRK vitin 2019 e kishte filluar me 18 raste të trashëguara të korrupsionit nga vitet paraprake me 66 persona të përfshirë. Gjatë periudhës raportuese (1 janar-30 shtator 2019) kjo prokurori ka pranuar 15 raste të reja me 77 persona të përfshirë. PSRK gjatë kësaj periudhe raportuese ka zgjidhur 5 raste të korrupsionit me 20 persona të përfshirë. Nga 20 personat subjekt të procedurave penale në PSRK, ndaj 13 prej tyre janë pushuar hetimet dhe ndaj shtatë personave lënda është zgjidhur në mënyrë tjetër, respektivisht në bazë të praktikës së instaluar nga kjo prokurori, lëndët ndaj këtyre personave janë deleguar në kompetencë tek Prokuroritë Themelore kompetente.

Rastet e korrupsionit në PSRK (1 janar – 30 shtator 2019)	Të pagjidhura në fillim (1 janar 2019)		Të pranuar (1 janar deri më 30 shtator 2019)		Të zgjidhura (1 janar deri më 30 shtator 2019)		Mënyra e zgjidhjes				Të pagjidhura në fund (30 shtator 2019)	
	Raste	Persona	Raste	Persona	Raste	Persona	Hudhje	Pushim	Aktakuzë	Mënyrë tjetër	Raste	Persona
							Persona	Persona	Persona	Persona		
PSRK	18	66	15	77	5	20		13		7	27	150

Tabela 8 – Rastet e trajtuara të korrupsionit nga PSRK në periudhën nëntëmujor 2019.

Qeveria dhe Kuvendi i Kosovës me qëllim të arritjes së rezultateve konkrete në luftimin e krimit të organizuar, korrupsionit të nivelit të lartë, veprave penale të pastrimit të parasë dhe financimit të terrorizmit, krimeve të luftës, dhe veprave penale më serioze, në fund të vitit 2018, ka miratuar Ligjin e ri për Gjykatat¹. Përmes këtij ligji, ishte vendosur që të ndryshoj organizimi i brendshëm i GjTh në Prishtinë, dhe Gjykatës së Apelit përmes themelimit të Departamentit Special për Lëndët në Kompetencë të Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës, me kompetencë për tërë territorin e Republikës së Kosovës.

Këshilli Gjyqësor i Kosovës në pajtim me obligimet e dalura nga Ligji për Gjykatat gjatë

¹ Ligji Nr. 06/L-054, për Gjykatat, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 22, 18 dhjetor 2018.

gjysmë vjetorit të dytë të vitit 2019, kishte arritur që të përfundoj procesin e plotësimit të vendeve të punës, si dhe të funksionalizoj këto dy departamente në GjTh në Prishtinë dhe Gjykatën e Apelit.

Në bazë të ligjit, këto dy departamente kanë kompetencë dhe përgjegjësi gjykimin e të gjitha veprave penale të parashtruara nga PSRK, ku hyn edhe veprat penale të korrupsionit.

Që nga funksionalizimi i departamentit special në GjTh në Prishtinë, PSRK gjatë vitit 2019 (1 janar – 30 shtator) nuk ka ngritur asnjë aktakuzë ndaj profilit të lartë për vepra penale që lidhen me korrupsionin. Megjithatë, sa i përket rasteve të gjykuara në Departamentin Special, ka një aktakuzë të re nga PSRK për vepra penale korruptive, jo ndaj personave të profilit të lartë, si dhe në të njëjtën kohë ka raste që po trajtohen në këtë Departament, e që janë raste të transferuara nga Departamenti i Krimeve të Rënda.

Edhe përkundër faktit se me Ligjin për PSRK, kjo prokurori ka të drejtë të ushtroj kompetenca plotësuese në trajtimin e rasteve të korrupsionit, në katër vitet e fundit e njehta në mënyrë të heshtur është duke anashkaluar ushtrimin e kësaj kompetence.

Kjo vërtetohet me faktin se PSRK *“shfrytëzon shumë pak ushtrimin e kompetencave plotësuese në trajtimin e rasteve të korrupsionit. Përderisa kjo prokurori, në vitin 2016 kishte pranuar në punë 12 lëndë të korrupsionit, në vitin 2017 ka pranuar vetëm katër lëndë të reja, kurse në vitin 2018, ka pranuar në punë gjashtë lëndë të reja të korrupsionit.”*²

Nëse PSRK vazhdon me këtë trend të ikjes së përgjegjesisë së trajtimit të rasteve të korrupsionit, përfshirë korrupsionin e nivelit të lartë, atëherë edhe themelimi i departamenteve speciale në kuadër të GjTh në Prishtinë dhe Gjykatën e Apelit, do të humb kuptimin dhe qëllimin për të cilin janë themeluar.

Karakteristikë tjetër e PSRK-së ndërlidhet me faktin se prokurorët në këtë prokurori nuk janë të profilizuar dhe specializuar në fusha të veçanta, përfshirë profilizimin në rastet e korrupsionit dhe krimeve ekonomike. Prokurorët në PSRK vazhdojnë që në të njëjtën kohë të trajtojnë lëndë të fushave të ndryshme. Tanimë është bërë praktikë që prokurorët e PSRK-së në të njëjtën kohë të hetojnë lëndë të krimit të organizuar, korrupsionit, krimeve të luftës, pastrimit të parasë, vrasjeve, trafikimit, etj.

Një qasje e tillë e sistemit prokurorial dhe PSRK, po ashtu ndikon në shpërndarjen e përgjegjesisë tek të gjithë prokurorët dhe uljen e efikasitetit në punë. PSRK në fund të kësaj periudhe raportuese ka mbetur me 27 lëndë të korrupsionit të papërfunduara ku përfshihen 150 persona.

Policia e Kosovës vazhdon të mbetet parashtruesi më i madh i lëndëve të korrupsionit edhe

² Instituti i Kosovës për Drejtësi, Raport-Pandëshkueshmëria e Korrupsionit, rrezik për shoqërinë dhe shtetin, mars 2019

në PSRK, me gjithsejt 68 lëndë, pasuar nga rastet e paraqitura nga qytetarët me 29 lëndë, dhe me 30 lëndë të pranuar në kompetencë nga Prokuroritë Themelore të Kosovës.

PARASHTRUESIT E KALLËZIMEVE PENALE	Të			Mënyra e zgjidhjes			Të pazgjidhura në fund (30 shtator 2019)
	pazgjidhura në fillim (1 janar 2019)	pranuara (1 janar deri më 30 shtator 2019)	zgjidhura (1 janar deri më 30 shtator 2019)	Hudhje	Pushim	Mënyrë tjetër	
	Persona	Persona	Persona	Persona	Persona	Persona	Persona
Agjencia Kundër Korrupsionit		1	1			1	
Policia e Kosovës	9	24					68
Qytetari	31	15	9		7	2	29
Prokurori me Vetiniciativë		12					12
Pranuar në kompetencë	9	25	4			4	30
Dogana e Kosovës	9						9
EULEX	8		6		6		2
Total:	66	77	20		13	7	150

Tabela 9 – Rastet e trajtuara të korrupsionit nga PSRK sipas parashtruesve në periudhën nëntëmujor 2019.

Situatë pothuajse e njejtë është edhe tek lëndët e regjistruara si PPN. PSRK në fillim të vitit 2019, kishte trashëguar 33 raste me 96 persona nga vitet paraprake, përderisa gjatë periudhës raportuese ka pranuar 55 raste me 138 persona të përfshirë. Nga 1 janari deri me 30 shtator 2019, PSRK ka zgjidhur 51 raste me 134 persona, ku ndaj 48 personave ka mbyllur hetimet, në asnjë rast nuk ka ngritur aktakuzë dhe ndaj 86 personave lëndët janë zgjedhur në mënyrë tjetër.

Rastet e korrupsionit në PSRK (1 janar – 30 shtator 2019)	Të pazgjidhura në fillim (1 janar 2019)		Të pranuara (1 janar deri më 30 shtator 2019)		Të zgjidhura (1 janar deri më 30 shtator 2019)		Mënyra e zgjidhjes				Të pazgjidhura në fund (30 shtator 2019)	
	Raste	Persona	Raste	Persona	Raste	Persona	Hudhje	Pushim	Aktakuzë	Mënyrë tjetër	Raste	Persona
							Persona	Persona	Persona	Persona		
PSRK	31	96	56	138	51	134	48			86	45	121

Tabela 10 – Rastet preliminare të korrupsionit të trajtuara nga PSRK në periudhën nëntëmujor 2019.

Numri më i madh i paraqitjes së rasteve PPN në PSRK janë nga qytetarët ndaj 55 personave, pasuar nga Policia e Kosovës ndaj 25 personave.


PARASHTRUESIT E KALLËZIMEVE PENALE	Të pazgjidh ura në fillim (1 janar 2019)	Të pranuara (1 janar deri më 30 shtator 2019)	Të zgjidhura (1 janar deri më 30 shtator 2019)	Mënyra e zgjidhjes			Të pazgid hura në fund (30 shtator 2019)
	Persona	Persona	Persona	Hudhje Persona	Pushim Persona	Mënyrë tjetër Persona	Persona
Agjencia Kundër Korrupsionit		1	1			1	
Policia e Kosovës	7	22	4	1		3	25
Qytetari	43	96	102	36		66	55
Pranuar në kompetencë	46	19	27	11		16	41
Total:	96	138	134	50		84	121

Tabela 11 – Rastet preliminare të korrupsionit të trajtuara nga PSRK sipas parashtruesve në periudhën nëntëmujor 2019.

IV. Politika e dënimeve për rastet e korrupsionit sipas Mekanizmit Përcjellës - KGJK

Politika e dënimeve në rastet e korrupsionit vazhdon të mbetet e ulët, e cila mbështetet kryesisht në shqiptimin e dënimeve më kusht dhe me gjobë. IKD vlerëson se këto dënime nuk e arrijnë qëllimin, duke pasur parasysh se dukuria e korrupsionit vazhdon të cilësohet si kancer i shoqërisë, zhvillimit ekonomik dhe perspektivës evropiane.


Politika e dënimeve në një analizë krahasuese të nëntëmujorit të parë të viteve 2018 dhe 2019 rezulton se në nëntëmujorin e vitit 2019 janë zgjidhur 37 lëndë me pak sesa në nëntëmujorin e vitit 2018. *(Shih grafikën)*



Grafika 4 – Trajtimi i rasteve të korrupsionit nga Gjykatat Themelore gjatë nëntëmujorit të parë të viteve 2018 dhe 2019.

Për dallim nga viti 2018, në vitin 2019 janë rritur dënimet me burg, kurse janë zvogëluar dënimet me kusht dhe gjobë dhe aktgjykimet liruese. *(Shih grafikën)*


**Mënyra e zgjidhjes së rasteve të korrupsionit nga Gjykatat Themelore
(Nëntëmuji i parë 2018 dhe 2019)**



Grafika 5 – Mënyra e zgjidhjes së rasteve të korrupsionit nga Gjykatat Themelore gjatë nëntëmuji të parë të viteve 2018 dhe 2019.

V. Monitorimi i rasteve të korrupsionit nga IKD

Monitoruesit e IKD-së, nga 1 janari e deri më 30 nëntor 2019 kanë monitoruar 908 seanca gjyqësore, ku përfshihen 296 raste të korrupsionit me 854 persona. Shih grafikën më poshtë.




Grafika 6 – Rastet e korrupsionit të monitoruara nga IKD (1 janar – 30 nëntor 2019).

a) Analizë e veçantë e rasteve të korrupsionit të profilit të lartë

Në këto 296 raste të korrupsionit të monitoruara nga IKD gjatë periudhës kohorë 1 janar – 30 nëntor 2019, janë përfshirë të gjitha profilet e personave të akuzuar. Prej 854 personave të akuzuar, 443 persona i takojnë profilit të ulët, 357 persona profilit të mesëm dhe 54³ persona i takojnë të profilit të lartë. (Shih grafikën)

³ Sqarim: Të dhënat për profilin e personave të lartë janë kalkuluar në bazë të Udhëzimit të Kryeprokuroorit të Shtetit, kur një veprë e korrupsionit do të konsiderohet e nivelit të lartë, të ndara në bazë të pozitës dhe vlerës së dëmit të shkaktuar (3 nëntor 2016)



Grafika 10 – Profili i personave të akuzuar në rastet e korrupsionit (janar-nëntor 2019).

b) Politika e dënimeve në rastet e korrupsionit

IKD vlerëson se politika e dënimeve në rastet e korrupsionit vazhdon të mbetet e butë. Gjatë kësaj periudhe, IKD ka raportuar për 138 aktgjykimet e shpallura nga Gjykatat Themelore të Republikës së Kosovës për raste të korrupsionit, ndaj 249 personave të përfshirë në raste të korrupsionit. Prej tyre, 219⁴ persona akuzohen për vepra të ndryshme korruptive, kurse 30 prej tyre janë të përfshirë në këto raste, mirëpo ngarkohen me vepra jo korruptive.

Në këto raste të korrupsionit në të cilat ka pasur shpallje të aktgjyimit, janë përfshirë të gjitha profilet e personave të akuzuar. Prej tyre, 74 persona i takojnë profilit të ulët, 118 persona profilit të mesëm dhe 27 persona i takojnë të profilit të lartë. *(Shih grafikën)*



Grafika 12 - Profili i personave të akuzuar për vepra penale të korrupsionit, për të cilët është shpallur aktgjykim në Gjykata Themelore gjatë periudhës raportuese (janar-nëntor 2019).

Në mesin e personave ndaj të cilëve Gjykatat Themelore kanë shpallur aktgjykime, e të cilët i takojnë profilit të lartë janë: ish-deputeti Naser Osmani (aktgjykim lirues), ish-kryetari i Komunës së Kllkotit Sasha Mirkoviq (aktgjykim lirues në tre raste), ish-ministri i

⁴ *Sqarim:* Nga 170 personat e akuzuar për vepra korruptive, për të cilët gjatë kësaj periudhe raportuese është shpallur aktgjykim nga shkalla e parë, 2 prej tyre janë të përfshirë në më shumë se një rast.

Shëndetësisë Ferid Agani (aktgjykim dënues – 30 muaj burg efektiv), ish-kryetari i Komunës së Skenderajt Sami Lushtaku (aktgjykim lirues), ish-kryetari i Organit Shqyrtues të Prokurimit Hysni Hoxha (aktgjykim lirues), ish-kryetari i Komunës së Klinës Sokol Bashota (aktgjykim dënues - gjashtë muaj burgim me kusht dhe 1000 euro gjobë), tre ish-drejtuesit e Postës dhe Telekomit të Kosovës, tash Telekomit të Kosovës, Agron Mustafa, Ejup Qerimi dhe Rexhë Gjonbalaj (aktgjykim lirues për secilin). Për shkak shumë të lartë të dëmit që dyshohet se është shkaktuar nga të akuzuarit me kryerjen e veprave penale, në kuadër të profilin të lartë hyjnë edhe zyrtarët e Agjencisë Kosovare të Privatizimit (AKP) Melita Ymeraga, Adrian Kelmendi, Bahri Shabani, Shkëlzen Lluka dhe Naim Avdiu (aktgjykim lirues për 5 personat), ish-sekretari i ministrisë së Shëndetësisë Gani Shabani (aktgjykim dënues – 24 muaj burg efektiv), ish-sekretari i përhershëm i Ministrisë së Shëndetësisë, Ilir Tolaj dhe katër të akuzuarit në cilësi të zyrtarëve të kësaj ministrie, Arbenita Pajaziti, Hajrullah Fejza, Zenel Kuqi e Bekim Fusha (aktgjykim lirues për secilin), ish-drejtori i Korporatës Energjetike të Kosovës (KEK) Arben Gjukaj (aktgjykim lirues), zyrtari i KEK-ut Azem Duraku (aktgjykim lirues), ish-drejtori i prokurimit në KEK Driton Pruthi (aktgjykim lirues), biznesmeni Esat Tahiri (aktgjykim lirues), kontraktuesit e KFOR-it për importimin e cigareve (aktgjykim dënues – nga 24 muaj burgim me kusht secili).

IKD pa dashur të komentojë meritën e vendimmarrjes në rastet gjyqësore të korrupsionit, shpreh shqetësimin se politika ndëshkimore që zbatohet nga gjykatësit në rastet e korrupsionit, nuk është duke dërguar mesazh të qartë të kryesit potencial të këtyre veprave penale. Këto dënime të buta të shqiptuara nuk mund të arrijnë qëllimin e vet për të cilat është shqiptuar dënimi, qoftë atë të karakterit ndëshkimor ndaj atyre, të cilët janë gjetur fajtor se kanë kryer vepra penale të korrupsionit, apo të karakterit preventiv, i cili ka për qëllim për të dërguar mesazhin e qartë tek personat të cilët mund të jenë subjekt i kryerjes së veprave penale të korrupsionit.

VI. Trajtimi i rasteve të korrupsionit në Gjykatën e Apelit

Në kuadër të monitorimit sistematik që i bën sistemit gjyqësor në Kosovë, IKD gjatë vitit 2019, ka monitoruar edhe Gjykatën e Apelit.

Për këtë periudhë raportuese (1 janar – 30 nëntor 2019), monitoruesit e IKD-së kanë monitoruar gjithsej 212 seanca të mbajtura në Gjykatën e Apelit, prej të cilave, 33 nga to ishin për raste të korrupsionit me gjithsej 63 të akuzuar për vepra penale të natyrës korruptive, kurse, seancat tjera të monitoruara kishin të bëjnë me vepra penale të fushave tjera.

Prej këtyre 33 seancave të monitoruara, vetëm një ishte shtyrë me kërkesë të avokatit mbrojtës së një të akuzuari, ndërsa, numri i vogël i seancave publike të mbajtura në Gjykatën e Apelit për raste të korrupsionit, pasqyron më së miri edhe politikën ndëshkimore të butë që gjykatat në Kosovë zbatojnë në rastet e korrupsionit.

Kjo pasi që vet ligji, konkretisht paragrafi 1 i nenit 390 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës ia mundëson Apelit që të mbajë seanca publike vetëm në raste kur dënimet e shqiptuara nga shkalla e parë janë me burg efektiv, e çka një gjë e tillë në rastet e korrupsionit në Kosovë është fenomen i rrallë.

Ashtu sikurse edhe në të kaluarën, as gjatë këtij viti, nuk është shqiptuar as edhe një aktgjykim dënues me burg efektiv për ndonjë të akuzuar të profilit të lartë sa i përket rasteve të korrupsionit.

Madje, Apeli gjatë kësaj periudhe ka anuluar edhe një aktgjykim të shkallës së parë, e cila në një rast të profilit të lartë kishte shqiptuar dënim me tre vjet burg efektiv për korrupsion dhe këtë lëndë e kishte kthyer në rigjykim. Në rigjykim, Gjykata e Apelit e ka kthyer edhe rastin e ish-kryetarit të Komunës së Klinës, Sokol Bashota, i cili nga shkalla e parë ishte dënuar me gjashtë muaj burg me kusht dhe 1000 euro gjobë për mos deklarim apo deklarim të rremë të pasurisë.

Ndryshe, gjatë kësaj periudhe, Gjykata e Apelit ka vendosur lidhur me ankesat e palëve edhe në disa raste të profilit të lartë.

- Më 30 maj 2019, Gjykata e Apelit i kishte liruar përfundimisht nga akuzat për korrupsion, zëvendëskryeministrin në detyrë, **Fatmir Limaj**, ministrin në detyrë të Tregtisë dhe Industrisë, **Endrit Shala** si dhe tre të akuzuarit tjerë në rastin “MTPT”, **Shpëtim Telaku, Nexhat Krasniqi dhe Florim Zuka**. Shkalla e dytë kishte refuzuar ankesën e Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës (PSRK), e cila për shkak të pretendimeve se aktgjykimi i Themelores ishte i përfshirë me shkelje, kishte kërkuar që çështja të kthehet në rigjykim.

Limaj dhe të tjerët në këtë rast akuzoheshin për krim të organizuar lidhur me veprat penale “Shpërdorimi i pozitës zyrtare ose i autorizimit”, “Marrje e ryshfetit”, “Dhënie e ryshfetit”, “Keqpërdorimi i autorizimeve në ekonomi” dhe “Mos deklarimi të parave të pranuar për fushatë”.

Për këtë rast, aktakuza e parë ishte ngritur me 5 dhjetor 2012, aktakuza e dytë më 19 shkurt 2014, kurse, aktakuza e konsoliduar ishte ngritur nga PSRK-ja, më 28 shtator 2015, me anë të së cilës ishin bashkuar dy aktakuza të mëparshme të rasteve MTPT 1 dhe MTPT 2.

Lidhur me këtë aktakuzë, GjTh në Prishtinë kishte nxjerr aktgjykim lirues për të gjithë të akuzuarit, më 24 nëntor 2017, ndërsa, Apelit i ishte dashur më shumë se një vit që të vendos lidhur me ankesën e PSRK-së kundër aktgjykimit të Themelores.

- Më pak kohë se kaq, Apelit i ishte dashur që ta anulojë një aktgjykim dënues të shqiptuar në një rast të profilit të lartë, siç është rasti “Ferronikeli”, ku i akuzuar për korrupsion është ish-kryetari i Komunës së Lipjanit, **Shukri Buja**, si dhe të akuzuarit **Nebih Zeqiri, Halit Gashi, Magbule Sadiku, Fahri Retkoceri, Hasim Vishesella, Edmond Rehxhepi, Driton Avdiu, Burim Kodra dhe Bajram Rizani**.

Veprat penale me të cilat ngarkohen të akuzuarit në këtë rast janë, “Keqpërdorim i pozitës zyrtare”, “Punët ndërtimore të kundërligjshme”, “Dhënia e ryshfetit”, “Marrja

e ryshfetit”, dhe “Ushtrimi i ndikimit”.

Ky rast, i cili edhe është i shënjestruar për liberalizim të vizave, kishte qenë një ndër rastet e rralla kur gjykatat në Kosovë kanë shqiptuar burg efektiv për të akuzuar të profilit të lartë, siç është Buja në këtë rast.

Mirëpo, aktgjykimin e Themelores të nxjerr më 5 nëntor 2018, e cila Bujën e kishte dënuar me tre vjet burg për korrupsion, e kishte anuluar Gjykata e Apelit më 12 qershor 2019, për shkak se siç thuhej në vendimin e Apelit, aktgjykimi i Themelores ishte i përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave procedurale.

Përveç Bujës, shkalla e parë fajtorë për keqpërdorim të pozitës zyrtare, i kishte shpallur edhe të akuzuarit e tjerë në këtë rast, Nebih Zeqiri, i cili ishte dënuar me dy vjet e gjashtë muaj burgim, Halit Gashi me gjashtë muaj burgim, Edmond Rexhepi është dënuar me gjashtë muaj burgim, Bajram Rizani me gjashtë muaj burgim, kurse Hasim Vishesella është shpallur fajtorë për marrje ryshfeti dhe është dënuar me pesë muaj burgim.

Ndërsa, ishin liruar nga akuza, Magbule Sadiku, Burim Kodra si dhe Driton Avdiu, kurse ndaj biznesmenit Fahri Retkoceri, aktgjykim lirues është marrë për veprën penale, punimet ndërtimore të kundërligjshme, kurse aktgjykim refuzues për shkak të parashkrimit, është marrë për veprën penale të dhënies së ryshfetit.

- Më 26 gusht 2019, Gjykata e Apelit i kishte liruar përfundimisht nga akuzat për korrupsion, ish-drejtorin e Agjencisë Kosovare të Akreditimit (AKA), **Basri Mujën**, ish-kryetaren e Këshillit Shtetëror e Cilësisë (KSHC) të AKA-së, **Ferdije Zhushi-Etemin** si dhe **Armend Mujën**.

Në këtë rast, i cili edhe është i shënjestruar për liberalizim të vizave, Apeli e kishte vërtetuar aktgjykimin e GJTh në Prishtinë, e cila më 29 janar 2019, i kishte liruar nga disa pika të akuzës, Basri dhe Armend Mujën si dhe Ferdije Zhushi-Etemi, kurse për disa pika të tjera kishte marr aktgjykim refuzues.

- Gjykata e Apelit, më 28 mars 2019, e kishte dënuar me burgim efektiv, ish-deputetin e Kuvendit të Kosovës, **Etem Arifi**. Arifi, i cili nga shkalla e parë ishte dënuar me dy vjet burgim me kusht për veprën penale të mashtrimit me subvencione, Apeli ia kishte ashpërsuar dënimin në burgim efektiv prej një vit e tre muaj.

Po ashtu, shkalla e dytë ia ka ashpërsuar dënimin edhe të akuzuarit tjetër në këtë rast, **Bajram Gashi**, duke e gjykuar të njëjtin me një vit burgim efektiv, për dallim nga shkalla e parë e cila e kishte dënuar Gashin me dy vjet burg me kusht për veprën penale të mashtrimit me subvencione.

Gjykata e shkallës së dytë, i kishte obliguar që të dy të akuzuarit, që t’ia kompensojnë Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS), në emër të dëmit të shkaktuar shumë prej 22.900 euro kurse Zyrës së Kryeministrit, shumë prej 2749 euro.

Gjithashtu, Apeli e kishte anuluar aktgjykimin e Themelores për sa i përket veprës penale të ushtrimit të ndikimit për çka deputeti Arifi ishte liruar nga akuzat nga shkalla e parë, duke e kthyer çështjen në rigjykim.

Megjithatë, ky aktgjykim i Apelit ishte anuluar pastaj nga Gjykata Supreme dhe lënda ishte kthyer në rivendosje, pasi që, Supremja kishte gjetur se e njëjta gjykatëse që kishte vendosur lidhur me ankesat në fazën e konfirmimit të aktakuzës, kishte marr pjesë edhe në kolegjin që e kishte nxjerr aktgjykimin në këtë lëndë.

Edhe pas kthimit në rivendosje, një kolegji i ri i Gjykatës së Apelit, kishte nxjerr sërish aktgjykim të njëjtë në këtë rast, duke e dënuar me burg efektiv ish-deputetin Arifi dhe të akuzuarin Gashi për veprën penale të mashtrimit me subvencione, kurse Arifin e kishte kthyer në rigjykim për veprën penale të ushtrimit të ndikimit

- Me 22 tetor 2019, Gjykata e Apelit e kishte anuluar aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Pejë dhe e kishte kthyer në rigjykim rastin ku për mos raportim apo raportim të rremë të pasurisë, po akuzohen ish-kryetari i Komunës së Klinës, **Sokol Bashota** dhe ish-nënkryetari i kësaj komune, **Enver Berisha**.

Sipas aktvendimit të Apelit, gjykata e shkallës së parë në aktgjykimin e saj nuk kishte dhënë arsye për çdo pikë të aktgjykimit, nuk ka vërtetuar saktësinë e provave kundërthënëse dhe arsyet në të cilat është bazuar në rastin e vërtetimit të ekzistimit të veprës penale. Sipas Apelit, aktgjykimi i shkallës së parë është marrë në shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, të cilat kanë ndikuar në vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike prandaj edhe është detyruar që rastin ta kthej sërish në rigjykim.

Gjatë kësaj periudhe, shkalla e dytë kishte pasur punë me raste të profilit të lartë edhe në fazën e konfirmimit të aktakuzës.

- Gjykata e Apelit kishte refuzuar ankesat e të akuzuarve dhe kishte lënë në fuqi aktakuzat në rastet e ish-kryetarit të Komunës së Gjakovës, **Pal Lekajt**, ish-kryetarit të Komunës së Gjilanit, **Qemajl Mustafa**, ish-kryetarit të Komunës së Suharekës, **Sali Asllanaj** si dhe Kryetarit të Komunës së Istogut, **Haki Rugova**.
- Në fuqi kishte mbetur edhe aktakuza ndaj ish-kryetarit të Komunës së Drenasit, **Nexhat Demaku**, por kjo kishte ndodhur pasi që paraprakisht, Apeli e kishte kthyer njëherë në rivendosje vendimin e Themelores.
- Gjithashtu, në gusht të këtij viti, Apeli i kishte refuzuar ankesat e të akuzuarve dhe e kishte lënë në fuqi edhe në rastin e njohur si “Veteranët”, ku të akuzuar për korrupsion janë, **Nuredin Lushtaku**, **Sadik Halitjaha**, **Shkumbin Demaliaj**, **Qelë Gashi**, **Shukri Buja**, **Ahmet Daku**, **Rrustem Berisha**, **Faik Fazliu**, **Smajl Elezaj**, **Fadil Shurdhaj** dhe **Xhavit Jashari**.
- Ndërsa, në një rast të rrallë, Gjykata e Apelit e kishte përmbysur vendimin e GjTh në Prishtinë e cila e kishte hudhur poshtë aktakuzën ndaj ish-shefave të Telekomit të Kosovës, **Agron Mustafa**, **Ejup Qerimi** dhe **Rexhë Gjonbalaj**, duke e udhëzuar shkallën e parë që në këtë rast të procedojë me gjykimin e të akuzuarve.
- Në raste tjera, ku nuk janë të përfshirë të akuzuar të profilit të lartë, Apeli gjatë këtij viti kishte vendosur për herë të dytë lidhur me ankesat e palëve edhe në rastin e njohur si “Kontrata”, ku të akuzuar për mashtrim në detyrë janë, **Hakif Veliun** dhe **Albert Rakipin**.

Herën e parë, Apeli kishte vendosur për këtë rast më 2 maj 2018, me ç’rast Veliu dhe Rakipi ishin dënuar me nga një vit burg efektiv për veprën penale të “mashtrimit në

detyrë”, për dallim nga shkalla e parë e cila dy të akuzuarit i kishte gjykuar me nga gjashtë muaj burg me mundësi të zëvendësimit me gjobë prej 10 mijë eurove, secili veç e veç. Mirëpo, kjo çështje ishte kthyer më pas në rivendosje nga Gjykata Supreme, por, më 16 prill 2019, Apeli kishte marrë sërish vendim të njëjtë sikurse herën e parë, ashtu që Veliu dhe Rakipi ishin dënuar përsëri me nga një vit burg efektiv. Në këtë rast kishte qenë i përfshirë edhe ish-rektori i Universitetit të Prishtinës, Enver Hasani, mirëpo i njëjti ishte liruar nga Apeli në maj 2018, vendim i cili ishte konfirmuar pastaj edhe nga Gjykata Supreme.

- Më 31 janar 2019, Gjykata e Apelit e kishte kthyer në rigjykim rastin e ish-gjykatëses së GjTh në Pejë, dega në Deçan, **Safete Tolaj**, djalit të saj, **Fisnik Tolaj** dhe zyrtarit policor, **Granit Shehaj**, pasi që, sipas Apelit, aktgjykimi i Themelores është përfshirë në shkelje esenciale të dispozitave esenciale të procedurës penale.

Sipas vendimit të Apelit, sa i përket pjesës refuzuese që ka të bëjë vetëm me veprën penale “mbajtja në pronësi në kontroll apo posedim të pa autorizuar të armëve” për të akuzuarin Fisnik Tolaj, aktgjykimi ishte vërtetuar. Ish-gjykatësja Tolaj dhe i akuzuari Shehaj, më 13 korrik të vitit 2018, ishin shpallur të pafajshme për të gjitha pikat e aktakuzës, kurse, Fisnik Tolaj, ishte dënuar me dënim unik prej katër vjet e gjashtë muaj burgim, pasi ishte shpallur fajtor për dy vepra penale “ushtrim i ndikimit” dhe “falsifikim i dokumentit”. Ky rast është i shënjestruar për liberalizimin e vizave.

- Gjatë kësaj periudhe, shkalla e dytë kishte vërtetuar aktgjykimet liruese edhe në rastin e anëtarëve të Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), **Tefik Sylejmani** dhe **Ekrem Salihut**, të cilët akuzoheshin për keqpërdorim të pozitës apo autoritetit zyrtar. Gjykata e shkallës së dytë e kishte refuzuar ankesën e ushtruar nga ana e PTh në Prishtinë, e cila kishte kërkuar nga Apeli që dy të akuzuarit t’i shpall fajtorë apo që çështjen ta kthej në rigjykim.
- Po ashtu, aktgjykimet liruese të shkallës së parë, Apeli i kishte vërtetuar edhe në rastin e ish-drejtorit të Pallatit të Rinisë dhe Sporteve, **Bajram Uka**, inspektorese së Administratës Tatimore të Kosovës (ATK), **Violeta Januzi** dhe udhëheqëses së Zyrës së Prokurimit në Spitalin Rajonal “Dr.Sami Haxhibeqiri”, në Mitrovicë, **Zylfije Halilin**. Të gjithë këta akuzoheshin se kanë kryer veprën penale të “keqpërdorimit të pozitës apo autoritetit zyrtar”.
- Vërtetim të aktgjykimit të shkallës së parë, mirëpo kësaj radhe atij dënues, Apeli kishte marrë në rastin e drejtorit të Spitalit Rajonal “Isa Grezda” në Gjakovë, **Ahmet Asllani** dhe pesë të tjerëve që akuzoheshin lidhur me një tender për furnizim me uniforma të këtij spitali. Në këtë rast, me nga gjashtë muaj burg me kusht për veprën penale “keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar”, ishin dënuar Asllani dhe i akuzuari, **Adnan Brovina**, për ushtrim ndikimi ishte dënuar **Skënder Ndrecaj**, ndërsa, **Mirlinda Mullahasani** dhe **Mentor Bytyqi** për falsifikim të dokumentit zyrtar. Po ashtu për falsifikim të dokumentit zyrtar, **Kumrije Kameri** ishte dënuar me tre muaj burgim me kusht, nëse brenda një viti nuk kryen vepër tjetër penale. Dënimet ndaj këtyre të akuzuarve nuk do të ekzekutohen në rast se të akuzuarit nuk kryejnë vepra tjera penale gjatë periudhës së verifikimit prej një viti nga plotfuqishmëria e

aktgjykimit.

Ndërsa, procedura penale ishte pushuar ndaj të akuzuarve për veprimtari të pandërgjegjshme ekonomike, **Mirlinda Shehu-Kaqi** dhe **Flamur Zeneli**, për shkak se s, ndaj këtyre dy të akuzuarve ka arritur parashkrimi relativ i ndjekjes penale.

- Dënimet e shqiptuara nga shkalla e parë, Apeli ia kishte vërtetuar edhe të akuzuarit **Nexhmi Ejupi**, i cili akuzohej se kishte tentuar që zyrtarëve policor të ju jap 50 euro ryshfet, si dhe në një rast tjetër, dy zyrtarëve tjerë policor, **Arben Shala** dhe **Tafa Murseli** të cilët akuzoheshin se kishin marr 100 euro për të mos hapur një rast penal.
- Po ashtu, Apeli ia ka vërtetuar dënimin edhe ish-drejtorit të Repartit të Urologjisë në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës (QKUK), **Rexhep Kasumaj**. Kasumaj është dënuar për marrje ryshfeti me nëntë muaj burg efektiv dhe 2000 euro gjobë.
- Më 4 tetor 2019, Gjykata e Apelit ia kishte vërtetuar dënimin me burg efektiv, ish-zyrtarit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit, **Taulant Tahirsylaj**. Kësisoj, Apeli kishte refuzuar ankesën e të akuzuarit të ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, e cila më 6 qershor 2019, e kishte shpallur atë fajtor keqpërdorim të pozitës apo autoritetit zyrtar dhe e kishte dënuar me burgim në kohëzgjatje prej 10 muajsh.
- E “mëshirshme”, Apeli ishte treguar në dy raste ku të përfshirë kishin qenë një numër i madh i zyrtarëve policor.

Në maj 2019, 15 prej 20 zyrtarëve të Policisë së Kosovës, të dënuar për marrje ryshfeti nga GjTh në Prizren, në janar të vitit 2018, u ishin zbutur dënimet nga Gjykata e Apelit. Nga kjo zbritje e dënimeve kishin përfituar të akuzuarit, **Shemsi Demolli, Safet Veliu, Naser Rama, Ivica Djokiç, Ismail Azemi, Blerim Zylfaj, Bekim Zogaj, Qerim Beqiri, Azem Goxhufi, , Sasha Nedeljkovic, Shaban Gerguri, Lulzim Gashi, Shefki Zeka dhe Muhamet Buzhala dhe Alush Elshani**. Kurse, gjykata e shkallës së dytë kishte vendosur që t’i refuzoj ankesat e ushtruara nga të akuzuarit **Ardian Rrecaj, Shemsi Zejnullahu, Aziz Krasniqi, Nuhi Zogaj dhe Afrim Rafuna**.

- Në mars 2019, Gjykata e Apelit ua kishte përgjysmuar dënimet me gjobë edhe ish-zyrtarëve të Policisë së Kosovës, **Neshat Avdaj, Driton Bajrami, Myzafer Sylejmani dhe Binak Bytyqi**, të dënuar nga shkalla e parë për marrje ryshfeti.
- Tutje, në raste tjera të vendosura nga Apeli gjatë nëntë muajorit të parë të vitit 2019, është edhe rasti i inspektorit të Komunës së Kamenicës, **Sadullah Dërmaku**, i cili dy herë ishte shpallur fajtor nga shkalla e parë, por që të herët, aktgjykimet janë anuluar nga Apeli dhe lënda aktualisht është duke u trajtuar nga GjTh në Gjilan për herën e tretë.
- Në rigjykim, Apeli e kishte kthyer edhe rastin e ish-drejtoreshës së Arsimit në Komunën e Mitrovicës, **Ajmane Barani**. e cila parapra kisht, ishte shpallur e pafajshme nga ana e GjTh në Mitrovicë.
- Me 6 nëntor 2019, Gjykata e Apelit kishte vendosur që të anulojë aktgjykimin e shkallës së parë, e cila i kishte liruar nga akuzat për keqpërdorim të pozitës apo autoritetit zyrtar, zyrtarët e Komunës së Prishtinës, **Shiqeri Spahiu, Ramush Thaqi dhe Doruntina Peqani**. Këtë rast, ku për veprën penale të mashtrimit ishte dënuar

nga shkalla e parë edhe **Naim Dushku**, Apeli e ka kthyer në rigjykim pasi i ka vlerësuar si të bazuara pretendimet ankimore të prokurorisë lidhur me mos vërtetimin e drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike.

- Pasi kishin kaluar më shumë se 10 vjet nga koha kur prokuroria pretendonte se ish-anëtari i Bordit të Kompanisë Rajonale të Ujësjellësit “Hidrodrini”, në Pejë, **Elez Hajdaraj**, kishte kryer veprën penale të përvetësimit në detyrë, Gjykata e Apelit ka ardhur në përfundim se kjo veprë tashmë është parashkruar. Për këtë arsye, më 17 maj 2019, Apeli ka vendosur që të refuzojë akuzën për këtë veprë ndaj Hajdarajt, kurse, shkalla e dytë e ka refuzuar edhe ankesën e PTh në Pejë për sa i përket veprës tjetër penale që akuzohej Hajdaraj, atë të frikësimit gjatë procedurës penale duke e liruar kështu përfundimisht nga kjo akuzë të akuzuarin.
- Gjykata e Apelit e kishte liruar përfundimisht nga akuzat për keqpërdorim të pozitës zyrtare, edhe ish-zyrtarin e prokurimit në Kompaninë Rajonale të Mbeturinave (KRM) “Pastërtia” në Ferizaj, **Ilir Beqiri**. E veçanta e këtyre të dy këto rasteve, të Elez Hajdarajt dhe Ilir Beqirit, është se Apelit i ishte dashur të vendosur nga tre herë në secilin prej tyre.

VII. Trajtimi i rasteve të korrupsionit nga Gjykata Supreme

Instituti i Kosovës për Drejtësi, gjatë këtij vitit 2019, ka monitoruar edhe Gjykatën Supreme, me ç’rast kjo e fundit kishte vendosur në disa raste të korrupsionit, ku përfshihen edhe zyrtar të profilit të lartë.

Duke qenë se Gjykata Supreme nuk mban seanca publike përveç në rastet kur Gjykata e Apelit e ndryshon aktgjykimin lirues të GjTh dhe e zëvendëson me aktgjykim dënues për të akuzuarin si dhe në rastet e shqiptimit të dënimeve maksimale apo dënimeve me burg të përjetshëm, monitorimi i Gjykatës Supreme është fokusuar më shumë në analizimin e vendimeve dhe mendimeve juridike të nxjerra nga Supremja.

Në të paktën pesë raste që IKD ka monitoruar gjatë kësaj periudhe, shihet se Gjykata Supreme kishte konstatuar shkelje që kishin bërë instancat më ulëta të gjyqësorit në favor të akuzuarve për korrupsion, por në pamundësi ligjore që të njëjtat t’i kthej në rigjykim, Supremja vetëm i kishte konstatuar shkeljet në fjalë.

Kjo, pasi sipas nenit 438, paragrafi 2, të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës, kur Gjykata Supreme e Kosovës çmon se kërkesa e paraqitur për mbrojtjen e ligjshmërisë në dëm të pandehurit është e bazuar, vetëm konstaton shkeljen e ligjit pa ndikuar në vendimin e formës së prerë.

- Më 21 janar 2019, kolegji i Gjykatës Supreme me përbërje të gjykatësve, Valdete Daka, Nesrin Lushta dhe Agim Maliqi kishte nxjerr një aktgjykim me të cilin kishte konstatuar se aktgjykimet e GjTh në Prishtinë dhe asaj të Apelit, në rastin e ish-

kryetarit të Komunës së Obiliqit, **Mehmet Krasniqi**, për sa i përket pjesës liruese, ishin marr me shkelje esenciale të dispozitave procedurale.

Kurse sa i përket pjesës gjyquese të aktgjykimeve në fjalë, Supremja e kishte refuzuar si të pabazuar kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë të ushtruar nga ana e Prokurorit të Shtetit.

Në maj të vitit 2017, GjTh në Prishtinë, në mungesë të provave kishte liruar nga akuza për keqpërdorim të pozitës zyrtare, ish-kryetarin e Komunës së Obiliqit, **Mehmet Krasniqi** si dhe zyrtarët e komunës në fjalë **Xhavit Krasniqi, Haki Raqi, Nazmi Gashi, Ramadan Hashanin, Bajram Palojin, Azem Spancën** dhe **Altin Preniqin** kurse **Hasnije Dushi** ishte liruar nga akuza për mashtrim në detyrë.

Ndërkaq, ndaj të akuzuarve për mashtrim, **Emir Sopjanit** dhe **Sami Kadriut**, gjykata kishte shpallur aktgjykim dënues, duke iu shqiptuar dënimin me nga 1 vit e 6 muaj burgim me kusht kurse **Bujar Alidema** dhe **Shpend Kelmendi** ishin dënuar me nga 2 vite burgim me kusht dhe 4,000 euro gjobë si dhe **Basri Kqiku** ishte dënuar me 1 vit burgim me kusht dhe 3,000 euro gjobë. Ky vendim pastaj ishte vërtetuar edhe nga Apeli.

Kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë në Supreme kishte paraqitur Prokurori i Shtetit i cili aktgjykimet e dy instancave më të ulëta të gjyqësorit i kishte atakuar për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe shkeljes së ligjit penal, dhe i kishte propozuar Gjykatës Supreme që të konstatojë se aktgjykimet në fjalë ishin marr me shkelje.

Duke aprovuar pjesërisht këtë kërkesë të Prokurorit të Shtetit, Supremja kishte konstatuar se shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale në rastin konkret konsiston në dhënien e arsyeve të paqarta për faktet vendimtare e sidomos me dashjen e të dënuarve për kryerjen e veprave penale për të cilët janë liruar nga akuza.

Duke qenë se shkeljet në këtë rast të gjykatës së shkallës së parë dhe asaj të Apelit kishin shkuar në favor të akuzuarve, Gjykata Supreme vetëm kishte konstatuar shkeljet në fjalë pa pasur mundësi që rastin ta kthejë në rigjykim.

- Gjykata Supreme, më 1 prill 2019, kishte konstatuar shkelje edhe në rastin e njohur si “Sekseri”, ku ish-drejtori i Krimeve Ekonomike në Policinë e Kosovës, **Emin Beqiri** akuzohej për keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar, pengim i të provuarit dhe moslajmërimi i veprave penale apo kryerësve të tyre, ndërsa **Rrahim Hashimi** akuzohej për ushtrim të ndikimit dhe mashtrim.

GjTh në Prishtinë, në qershor 2018 kishte refuzuar ankesat e të akuzuarve në fjalë të cilët kishin kërkuar hudhjen poshtë të aktakuzës. Pas ankesave që kishin bërë mbrojtësit e të akuzuarve në Apel, kjo e fundit e kishte hudhur poshtë akuzën dhe kishte pushuar procedurën penale sa i përket të akuzuarit Beqiri kurse kishte kthyer në rivendosje sa i përket të akuzuarit Hashimi. Pas rivendosjes, shkalla e parë sërish e kishte konfirmuar akuzën për Hashimin, mirëpo, pas ankesës së mbrojtësit të tij, Apeli e kishte pushuar procedurën penale për veprën penale të ushtrimit të ndikimit, kurse e kishte refuzuar ankesën e mbrojtjes për veprën penale të mashtrimit.

Kundër këtyre aktvendime Prokurori i Shtetit kishte ushtruar kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe për shkak të shkeljes së ligjit penal, me propozim që Gjykata Supreme të konstatojë se

aktvendimet e Gjykatës së Apelit të Kosovës përmbajnë shkelje të dispozitave e të procedurës penale si dhe shkelje të ligjit penal, apo çështja të kthehet në rivendosje.

E këtë kërkesë të Prokurorit të Shtetit e kishte aprovuar si të bazuar, kolegji i Supremes në përbërje të gjykatësve Agim Maliqi, Valdete Daka dhe Rasim Rasimi. sipas të cilëve, me të gjitha provat e dorëzuara nga prokuroria, të cilat janë në përputhje me njëra tjetrën, Gjykata e Apelit ka ardhur në përfundim të gabuar kur ka konstatuar se nuk ka pasur asnjë provë e cila ka involvuar Emin Beqirin në veprat penale për të cilat është akuzuar.

Sipas Supremes, gjykata e shkallës së dytë duke e marrë rolin e gjykatës së shkallës së parë ka pamundësuar që të vërtetohet apo jo fajësia e të pandehurve si dhe vërtetësia apo jo e provave të paraqitura nga prokuroria, e duke i vlerësuar vet provat, edhe pse në mesin e këtyre provave ka pasur prova të cilat e kanë mbështetur dyshimin e bazuar mirë se këta i kanë kryer veprat për të cilat janë akuzuar.

- Gjykata Supreme, përkatësisht kolegji i përbërë nga gjykatësit Agim Maliqi, Nesrin Lushta dhe Rasim Rasimi, më 5 qershor 2019, kishte nxjerr aktgjykim me të cilin kishte konstatuar se aktgjykimet e GjTh në Prishtinë dhe asaj të Apelit, në rastin e ish-kryetarit të Gjykatës së Apelit, **Salih Mekaj** ishin marr me shkelje të ligjit penal.

Supremja kishte konstatuar se shkeljet në fjalë kishin të bënin sa i përket të akuzuarit Mekaj për veprën penale të ushtrimit të ndikimit dhe për të akuzuarën Vlora Gorani, për veprën penale të shtytjes në ushtrimit të ndikimit, kurse ishte refuzuar si e pabazuar kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë të Prokurorit të Shtetit të Kosovës e ushtruar kundër këtyre aktgjykimeve, për sa i përket të akuzuarve **Vlora Gorani, Mentor Seferaj dhe Ali Seferaj** në pjesën që ka të bëjë me të pandehurit për veprën penale dhënia e ryshfetit në tentativë.

Të gjithë këta të akuzuar ishin liruar nga akuzat për të cilat ngarkoheshin nga GjTh në Prishtinë, në maj 2018, kurse aktgjykimi liruës ishte vërtetuar pastaj edhe nga ana e Gjykatës së Apelit, në tetor 2018.

Sipas Supremes, shkalla e parë dhe ajo e dytë në aktgjykimet e veta në mënyrë të drejtë dhe të plotë kanë vërtetuar faktet vendimtare të çështjes konkrete por me lirimin e të akuzuarve, Mekaj dhe Goranit kanë nxjerr përfundimeve të gabuara për ekzistimin e veprës penale, që paraqet shkelje të ligjit penal sepse kanë aplikuar ligjin i cili nuk ka mundur të aplikohet, sepse me aplikimin e drejtë të ligjit penal, sipas Supremes, Mekaj do duhej të shpallej fajtor për veprën që është objekt i akuzës.

Veprimet e Mekajt, sipas Supremes, sipas fakteve të cekura në aktgjykim, paraqesin ushtrim të ndikimit, duke qenë se shkas për bisedat m gjyqtaren L.M, ka qenë lidhja e Mekajt me Goranin e cila nuk ka ekzistuar me herët por ka ndodhur pasi Goranit kishte shkuar për tu interesuar për lëndën e bashkëshortit të saj që akuzohej për një vepër penale. Sipas Supremes, pa iniciativën e Goranit, i pandehuri Mekaj, nuk ka filluar bisedat me gjyqtaren, së paku nga provat e nxjerra nuk del se më parë, ka filluar këto biseda.

Në vendimin e saj, Supremja thekson se fakti se nuk ka pasur sukses gjegjësisht ndikimi nga Mekaj nuk ka arritur rezultatin e synuar nuk e ndryshon pozitën juridiko penale e të pandehurit, siç parashihet me dispozitën e nenit 431.par.1.të KPK.

Edhe në këtë rast, meqenëse shkeljet ishin bërë në dobi të akuzuarve, Supremja vetëm

kishte konstatuar shkeljet pa pasur mundësi që rastin ta kthej në rigjykim.

- Në qershor 2019, Gjykata Supreme e kishte kthyer në rivendosje rastin e ish-deputetit të Kuvendit të Kosovës, **Etem Arifi** i cili akuzohet për veprat penale të mashtrimit me subvencione dhe ushtrim të ndikimit si dhe të akuzuarit **Bajram Gashi**, i cili akuzohej për mashtrim me subvencione.

Supremja e kishte anuluar vendimin e marrë në mars 2019 nga ana e Gjykatës së Apelit me të cilin ish-deputeti Arifi dhe i akuzuari Gashi, ishin dënuar me burg efektiv për veprën penale të mashtrimit me subvencione, kurse ishte vendosur të rigjykohej për veprën penale të ushtrimit të ndikimit.

Sipas vendimit të Gjykatës Supreme, kolegji i Gjykatës së Apelit që kishte nxjerr aktgjykimin në fjalë, kishte pasur në përbërje edhe një gjykatëse e cila kishte qenë pjesë e kolegjit të Apelit edhe në fazën e konfirmimit të aktakuzës gjë e cila është në kundërshtim me nenin 39, paragrafi 2 të Kodit të Procedurës Penale, i cili ndër të tjera ka paraparë se një gjyqtar përjashtohet në rast se ka marr pjesë në procedura të mëhershme në të njëjtin rast penal.

- Gjykata Supreme e Kosovës kishte konstatuar shkelje edhe në rastin e lirit nga akuza për marrje të ryshfetit, me të cilën ngarkohej inspektori i Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale (KPM), **Lulzim Çitaku**.

Nga një akuzë e tillë, ai ishte liruar nga GjTh në Pejë, e më pas pafajësinë ia kishte vërtetuar edhe Gjykata e Apelit, por, Supremja ka vlerësuar se gjykata e shkallës së parë dhe ajo e dytë, kanë shkelur ligjin penal, duke vepruar në favor të inspektorit Çitaku.

Gjykata Supreme një konstatim të tillë e ka dhënë më 11 korrik të këtij viti, pas kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë që e ka paraqitur prokurorja Sahide Gashi, pas aktgjykimeve të Themelores e Apelit.

Sipas Supremes, gjykata e shkallës së parë dhe ajo e dytë në aktgjykimet e veta, me lirim e të pandehurit sa i përket veprës penale të marrjes së ryshfetit kanë nxjerrë përfundime të gabuara për ekzistimin e saj dhe kanë aplikuar ligjin i cili nuk ka mundur të aplikohet, sepse me aplikimin e drejtë të ligjit penal ai do të shpallej fajtor për veprën penale që ishte objekt i akuzës.

Gjykata Supreme e kishte pranuar si të bazuar kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë së paraqitur nga Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit edhe në rastin e ish-drejtorit të Urbanizmit në Komunën e Gjilanit, **Valon Shefkiu**, shefit të inspeksionit të ndërtimit, **Milot Shkodra**, inspektorëve **Baki Azemi** e **Bahrije Beqiri**, si dhe të akuzuarit për heqje ose dëmtim të vulave zyrtare ose shenjave, **Abdyl Brestovci**.

Përveç, të akuzuarit Azemi, të gjithë të akuzuarit tjerë ishin liruar nga akuzat nga Gjykata Themelore në Gjilan, aktgjykim i cili ishte vërtetuar pastaj edhe Gjykata e Apelit.

Mirëpo, kolegji i Gjykatës Supreme, në përbërje nga gjykatësit, Valdete Daka, Agim Maliqi dhe Nesrin Lushta, ka konstatuar se shkalla e parë dhe e dytë, me rastin e vendosjes për këta të akuzuar, kishin shkelur ligjin në favor të të akuzuarve.

Ndërsa, sa i përket të akuzuarit Baki Azemi, Supremja ka refuzuar si të pabazuar kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë së paraqitur nga mbrojtja e tij.

VIII. Konkluzionet

- PSRK njëjtë sikurse edhe në vitet e kaluara (2016, 2017, dhe 2018) edhe në vitin 2019, vazhdon me trendin e ikjes në marrjen e përgjegjësive në trajtimin e rasteve të korrupsionit. Kjo Prokurori nga 1 janari 2019 deri më 30 shtator 2019 nuk ka ngritur asnjë aktakuzë ndaj profilit të lartë për vepra penale korruptive. Qasja e tillë e PSRK-së, është duke humbur kuptimin dhe logjikën e themelimit të Departamentit Special në kuadër të Gjykatës Themelore në Prishtinë dhe Gjykatën e Apelit, lidhur me kërkesën për rezultate konkrete në luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit.
- Karakteristikë tjetër e PSRK-së ndër lidhet me faktin se prokurorët në këtë prokurori nuk janë të profilizuar dhe specializuar në fusha të veçanta, përfshirë profilizimin në rastet e korrupsionit dhe krimeve ekonomike. Prokurorët në PSRK vazhdojnë që në të njëjtën kohë të trajtojnë lëndë të fushave të ndryshme. Tanimë është bërë praktikë që prokurorët e PSRK-së në të njëjtën kohë të hetojnë lëndë të krimit të organizuar, korrupsionit, krimeve të luftës, pastrimit të parasë, vrasjeve, trafikimit, etj. Mungesa e profilizimit të prokurorëve, dhe shpërndarja e rasteve të korrupsionit dhe krimeve ekonomike të një numër i madh i prokurorëve në PSRK është edhe tendencë dhe politikë e kësaj prokurorie në shpërndarjen e përgjegjësisë dhe llogaridhënies.
- Prokuroritë edhe në këtë vit vazhdojnë me hetimin dhe ndjekjen penale kryesisht të zyrtarëve që i takojnë profilit të ultë, respektivisht prokuroritë kanë pasur në punë lëndë të korrupsionit ndaj 412 personave që i takojnë profilit të ultë, ndaj 310 personave që i takojnë profilit të mesëm dhe ndaj 53 personave që i takojnë profilit të lartë.
- Politika ndëshkimore të rastet e korrupsionit ende mbetet sfidë për gjykatësit në të gjitha gjykatat e Kosovës. Sistemi gjyqësor ende nuk është në gjendje të zbatoj politikë ndëshkimore unike dhe në pajtim me frymën dhe qëllimin e vet Kodit Penal të Kosovës. Edhe gjatë kësaj periudhe raportuese numri më i madh i denimeve të shqiptuara nga gjykatat janë dënime me kusht dhe me gjobë, pasuar nga dënimet me burgim. Sidoqoftë, viti 2019, në krahasim me vitet paraprake për herë të parë ka shënuar ngritje të numrit të dënimeve me burgim efektiv të shqiptuara nga gjykatat e Kosovës.
- Këshilli Prokurorial dhe Këshilli Gjyqësor i Kosovës ende nuk kanë dëshmuar se janë efikas dhe efektiv mekanizmat e vlerësimit të performancës dhe disiplinimit për prokurorët dhe gjykatësit. IKD ka identifikuar konkretisht me mijëra lëndë të prokurorëve dhe gjykatësve, të cilët kanë bërë shkelje të vazhdueshme në trajtimin e rasteve të korrupsionit, për të cilat vetëm ka pasur inicim të procedurave disiplinore, por assesit nuk ka pasur masa adekuate disiplinore për të mbajtur përgjegjës shkelësit e ligjit.

- Mungesa e kontrollit gjyqësor në fazën e hetimeve preliminare vazhdon të përbën një prej formave më persekutuese të hetimit dhe ndjekjes së qytetarëve apo zyrtarëve që janë subjekt të kallëzimeve të ndryshme penale. IKD ka identifikuar këtë problem, ende të paadresuar, të zhvillimit të hetimeve nga policia dhe prokuroria, pa asnjë kontroll efektiv të gjyqësorit. Ky fenomen vazhdon të persekutojë palët e ndryshme, në të cilat bëhen shkelje të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, duke i mbajtur padrejtësisht në evidenca të procedurave penale dhe rrjedhimisht pa pasur të drejtën që për këto persekutime të ankohen në gjykatë. IKD ka identifikuar një numër të madh të rasteve të vjetra, të cilat janë denoncuar për korrupsion, por të cilat mbahen ende në sirtarët të prokurorive.

IX. Rekomandimet

- Prokurori i Shtetit gjatë hartimit të aktakuzave duhet të ngrisë kualitetin e tyre, dhe të njëjtat t'i bazoj në fakte, dëshmi, përfshirë mbrojtjen profesionale të tyre para gjykatës.
- Prokurori i Shtetit duhet të zbatoj obligimet ligjore lidhur me identifikimin e pasurisë së fituar me vepër penale, dhe të paraqesin kërkesa për sekuestrim dhe konfiskim të pasurisë së fituar përmes veprave penale.
- PSRK duhet të ushtrojë mandatin e saj ligjor dhe të merr rol udhëheqës në hetimin dhe ndjekjen e veprave penale të korrupsionit të nivelit të lartë.
- Gjykatat në Kosovë duhet të unifikojnë politikën ndëshkimore, duke përfshirë zbatimin e Udhëzuesit për Politikën Ndëshkimore në rastet e korrupsionit.